 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 1 of 23

Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit të akreditimit

Zbatues: Stafi i DPA, kryevlerësuesit, vlerësuesit teknikë dhe ekspertët, anëtarët e gupeve teknike të punës.


Përgjegjës për zbatimin: Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësore dhe Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese

Kontrolloi : Menaxheri i cilësisë

Ardita MELE

Miratoi : Drejtor i Përgjithshëm

Pranvera FAGU

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Page 2 of 23

1. QËLLIMI

Kjo procedurë specifikon në detaje gjithë procesin e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit të akreditimit (riakreditimit), proceset dhe personat e përfshirë në akreditim, përgjegjësitë dhe autoritetet e tyre që nga aplikimi për akreditim, deri në vendimin për riakreditim dhe ciklin e akreditimit.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm i DPA, dhe grupet teknike të punës të përfshira në proceset e akreditimit. Kjo procedurë zbatohet kur ka kërkesa për akreditim dhe riakreditim, nga Organet e Vlerësimit të Konformitetit (OVK) si dhe në rastet e mbikëqyrjes së organeve të akredituar.

3. PËRGJEGJËSITË

Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë dhe Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të kësaj procedure.

4. REFERIMET

- Standardi ISO / IEC 17011:2017 “Vlerësimi i Konformitetit - “Kërkesat për organizmat e akreditimit të cilat akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit” (Kapitulli 7)
- Ligji Nr. 116/2014“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 92/2023,
- Manuali i Cilësisë të DPA DA-MC-001
- Politika e vlerësimit DA-PO-002
- Politika në lidhje me grupin e vlerësimit DA-PO-003
- Politika për klasifikimin e moskonformiteteve DA-PO-013
- Politika për fushën e zbatimit të akreditimit DA-PO-015
- Procedura e vizitës vlerësuese DA-PT-002
- Forma e aplikimit për laboratorët DA-FO-022
- Formulari i aplikimit për trupat certifikues DA-FO-023
- Formulari i aplikimit për trupat inspektues DA-FO-018



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al


Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit

Kodi: DA - PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Faqe 3 of 23

- Deklaratë për konfidencialitetin, paanshmërinë dhe konfliktin e interesit DA-FO-010
- Check list për laboratorët testues DA-FO-020
- Check list për laboratorët kalibrues DA-FO-021
- Check list në lidhje me ISO 15189 DA-FO-064
- Check list në lidhje me ISO 17020 DA-FO-019
- Check list në lidhje me ISO 17024 DA-FO-025
- Check list në lidhje me ISO 17065 DA-FO-017
- Check list në lidhje me ISO/IEC 17021-1 DA-FO-035
- Forma për planin e vlerësimit DA-FO-002
- Forma e paraqitjes së moskonformiteteve DA-FO-003
- Forma e njoftimit të datës së vlerësimit dhe miratimi i saj DA-FO-005
- Forma e paraqitjes së veprimeve korrigjuese dhe verifikimi i tyre nga DPA DA-FO-011
- Forma e planit të zgjidhjes së moskonformiteteve DA-FO-032
- Database për tarifat e akreditimit DA-DT-002
- Forma e raportimit të vlerësimit per laboratore sipas ISO/IEC 17025 DA-FO-001
- Forma për takimin e grupit të vlerësimit DA-FO-070
- Programi i vlerësimit të laboratorëve testues DA-FO-069
- Programi i vlerësimit të laboratorëve kalibrues DA-FO-084
- Programi i vlerësimit të laboratorëve mjekësorë DA-FO-085
- Programi i vlerësimit të organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit DA-FO-086
- Programi i vlerësimit të organeve certifikuese të personave DA-FO-087
- Programi i vlerësimit të organeve inspektuese DA-FO-088
- Forma për raportimin e vlerësimit sipas ISO/IEC 17021-1 DA-FO-004
- Forma për raportimin e vlerësimit sipas ISO 17065 DA-FO-049
- Forma për raportimin e vlerësimit sipas ISO 17024 DA-FO-013
- Forma për raportimin e vlerësimit sipas ISO 17020 DA-FO-048
- Forma për raportimin e vlerësimit sipas ISO 15189 DA-FO-063
- Forma e njoftimit të emrave të grupit dhe aprovimit të tij DA-FO-012
- Forma e vlerësimit të dokumentacionit të sistemit të menaxhimit DA-FO-006
- Forma e vlerësimit të procedurave teknike DA-FO-007
-
- Forma e raportimit tek Drejtori i Përgjithshëm DA-FO-016.
- Kontrolli i regjistrimeve DA-PM-009
- Obligimet e OVK DA-PM-011
- Procedura e menaxhimit të informacionit

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 4 of 23

të website-it dhe intranetit të DPA	DA-PT-014
- Forma e raportimit të paravlerësimit	DA-FO-043
- Procedura për menaxhimin e Riskut të paanshmërisë	DA-PM- 019

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Për qëllimet e këtij dokumenti janë përdorur termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017 dhe shkurtimeve të listuara në Manualin e Cilësisë së DPA.

6. PËRSHKRIMI I PROCEDURËS SË AKREDITIMIT FILLESTAR


6.1 Kërkesa për informacion në lidhje me procedurën.

Një OVK mund të bëjë kërkesë (me fax ose letër) pranë DPA, për tu informuar me procedurat e akreditimit dhe dokumentat përkatës që nevojiten për të qene i akredituar

Jo më vonë se 15 ditë nga marrje e kërkesës, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, zhvillon një takim paraprak me OVK, gjatë të cilit, DPA, i jep OVK të gjithë informacionin e duhur për procedurën fillestare të akreditimit/mbikëqyrjes/riakreditimit, politikat dhe procedurat përkatëse, tarifat si dhe të sqarojë cdo pyetje të OVK. Ky informacion është i vlefshëm gjithashtu në faqen zyrtare të DPA, www.dpa.gov.al

Gjatë takimit paraprak, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, kërkon informacion në lidhje me OVK, fushën e aplikimit për akreditim, numrin e punonjësve, numrin e vendndodhjeve dhe adresat e OVK dhe detajet e kontaktit të personit të autorizuar. Këtë informacion Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, e përdor për analizën e burimeve.

6.2 Aplikimi për akreditim.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 5 of 23

OVK bën kërkesë zyrtare për akreditim. DPA dhe OVK nënshkruajnë kontratën, sipas formës DA-FO-038. Brenda pesë ditësh nga nënshkrimi i kontratës, specialisti i autorizuar për trajtimin e kontratave në DPA njofton me email drejtorin e drejtorisë përkatëse. OVK njoftohet për detyrimin e kryerjes së pagesës për aplikim dhe tarifës administrative. OVK duhet të dorëzojë konfirmimin e bankës për demonstrimin e kryerjes së pagesës. Kur pagesa është kryer me sukses, OVK ka të drejtë të dorëzojë formën e aplikimit dhe dokumentat/rregjistrimet e tjera të sistemit të menaxhimit që demostrojnë plotësimin e kërkesave për akreditim.


Pasi ka dorëzuar formën e aplikimit të plotësuar nga OVK, check listën e plotësuar dhe të gjithë dokumentacionin/ informacionin e nevojshëm që demonstroi përputhshmërinë me kërkesat e akreditimit, OVK tashmë quhet “Aplikant për akreditim”. Lista e dokumentacionit që nevojitet, por jo e limituar, jepet në format përkatëse për akreditim. OVK mund të dorëzojë dokumenta brenda 10 ditëve nga kryerja e pagesës. Në ndonjë rast, kur gjatë aplikimit apo procesit të vlerësimit fillestar/akreditimit, evidentohen mashtrime, apo nëse OVK qëllimisht jep informacion të rremë, ose fsheh informacion, DPA refuzon aplikimin dhe përfundon procesin e vlerësimit. I gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga OVK së bashku me një kopje të kontratës i kalon Drejtorit të drejtorisë përkatëse.

6.3 Shqyrtimi i burimeve

Pas marrjes së aplikimit, bazuar në dokumentat e dorëzuara dhe informacionin e siguruar nga takimi paraprak, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibruer dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, analizon burimet e DPA për ofrimin e akreditimit për skemën dhe fushën e kërkuar. Analiza konsiston në të paktën:

- a) Analizën e burimeve njerëzore të DPA
- b) Nëse OVK është një organ i lidhur,
- c) Analizën e procedurave përkatëse të DPA dhe
- d) Analizën e aftësisë së DPA për të kryer vlerësimin fillestar në kohën e duhur sipas kësaj procedure.
- e) Vlefshmërinë / verifikimin e skemës së akreditimit/vlerësimit të konformitetit të kërkuar.


6.3a) Analiza e burimeve njerëzore konsiston në ekzistencën e kryevlerësuesit, vlerësuesve teknikë dhe / ose ekspertëve teknikë për fushën përkatëse të akreditimit, në databasen DPA për vlerësuesit dhe kompetencën e tyre për të kryer vlerësimin në emër të DPA. Gjithashtu përfshihet edhe analiza e kompetencave të

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit</p>	<p>Kodi: DA – PT - 001</p> <hr/> <p>Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024</p> <hr/> <p>Faqe 6 of 23</p>
---	--	--

vendimmarrësve. Kur këto burime nuk janë të mjaftueshme, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, informon Drejtorin e Përgjithshëm për marrjen e vendimeve të tilla si: rekrutimi dhe / ose trajnimi i kryevlerësuesit / vlerësuesve / ekspertëve, përdorimi i vlerësues / ekspertë të huaj ose nënkontraktimi i një tjetër Organizëm Akreditues për kryerjen e vlerësimit. Përdorimi i vlerësuesve / ekspertëve të huaj kryhet nga DPA vetëm kur nuk ka burime të brendshme të vlefshme ose kur nuk sigurohet paañshmëria Në mungesë të kompetencës së vendimmarrësve, ose kur çënohet paañshmëria DPA do të kërkojë rekomandimin për akreditim nga grupi teknik i punës përkatës i DPA.

- 6.3b) Nëse OVK është organ i lidhur, DPA e regjistron atë në databasen e organeve të lidhur dhe kryen vlerësimin sipas kësaj procedure.
- 6.3c) Analiza e procedurave përkatëse, përfshin ekzistencën e kritereve dhe procedurave për procesin e akreditimit/skemës së vlerësimit të konformitetit. Kur këto burime nuk janë të mjaftueshme, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, informon Drejtorin e Përgjithshëm i cili vendos për fillimin e procedurës së zgjerimit të aktivitetit të DPA, DA-PM-008. Nëse DPA vendos të mos ofrojë akreditim për skemën e re, informon pa vonesë OVK dhe ka të drejtë të refuzojë aplikimin për akreditim.
- 6.3d) Nëse DPA nuk ka mundësi të respektojë afatet për kryerjen e vlerësimit fillestar, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësore/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, informon Drejtorin e Përgjithshëm dhe OVK për kohën se kur mund të fillojë procesit të akreditimit fillestar.
- 6.3e) Nëse vlefshmëria / verifikimi i skemës së vlerësimit të konformitetit për të cilën OVK kërkon akreditim është i nevojshëm, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësore/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, informon dhe kërkon nga Drejtori i Përgjithshëm që të iniciojë validimin / verifikimin e skemës së vlerësimit të konformitetit sipas DA-PM-008. DPA informon OVK se procesi i akreditimit do të fillojë vetëm pas vlefshmërisë / verifikimit pozitive të skemës.

Nëse nga analiza rezulton që DPA ka të gjitha burimet për të akredituar skemën e akreditimit të kërkuar, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit</p>	<p>Kodi: DA – PT - 001</p>
		<p>Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024</p>
		<p>Faqe 7 of 23</p>

mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, cakton nga stafi i brendshëm i DPA, menaxherin e dosjes për të shqyrtuar aplikimin brenda 15 ditëve.

Kur nga shqyrtimi i aplikimit gjenden jokonformitete, menaxheri i dosjes i propozon Drejtorit të Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, të mos procedojë me procesin e akreditimit (forma DA-FO-006). Të gjitha jokonformitetet raportohen nga menaxheri i dosjes dhe Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, tek Drejtori i Përgjithshëm. DPA dërgon tek OVK formën DA-FO-006 ku jepen shmangiet e gjetura dhe i kërkon OVK t'i zgjidhë ato dhe të dorëzojë dokumentacionin e veprimeve të ndërmarra për zgjidhjen e tyre. OVK ka të drejtë të përgjigjet (të mbyllë moskonformitetet e gjetura dhe të dorëzojë rregjistrimet e veprimeve të ndërmarra) brenda 6 muajve nga data e raportimit të fundit nga ana e DPA. Nëse OVK nuk e respekton këtë afat, DPA informon OVK se aplikimi është refuzuar. Aplikimi për akreditim arshivohet. OVK duhet të aplikojë përsëri për akreditim.


Kur nuk ka jokonformitete, menaxheri i dosjes i raporton Drejtorit të Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, dhe i rekomandon vazhdimin e procesit të akreditimit (forma DA-FO-006).

DPA kryen vizitë paravlerësuese me kërkesë të OVK ose me kërkesë të saj, kur DPA ka dyshime që sistemi i menaxhimit nuk funksionon. Kur vizita paravlerësuese propozohet nga DPA, kërkohet miratimi i OVK. Vizita paravlerësuese do të kryhet në zyrën qendrore të OVK. Ajo zgjat jo më shumë se një ditë. Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese emëron një kryevlerësues dhe kërkon miratimin e tij nga OVK. Kryevlerësuesi konfirmon me OVK datën dhe planin e vizitës paravlerësuese. Kryevlerësuesi kryen vizitën paravlerësuese në përputhje me procedurën e vizitës vlerësuese (DA-PT-002). Nëse gjatë vizitës paravlerësuese janë gjetur jokonformitete, ato raportohen sipas DA-FO-003 dhe OVK duhet të ndërmarrë veprime përkatëse për zgjidhjen e tyre. Të gjitha jokonformitetet duhet të raportohen në raportin e paravlerësimit sipas formës DA-FO-043. Koha maksimale për zgjidhjen e jokonformiteteve nga ana e OVK, është 6 muaj.

Pas kryerjes dhe zbatimit të veprimeve korigjuese, OVK informon me shkrim DPA për zgjidhjen e jokonformiteteve dhe gatishmërinë e saj për vizitën e vlerësuese.

6.4 Përgatitja për vlerësim

Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese brenda 10 ditëve nga rekomandimi i menaxherit të dosjes për vazhdimin e procesit të akreditimit apo nga informimi për gatishmërinë për

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Procedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit</p>	<p>Kodi: DA – PT - 001</p>
		<p>Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024</p>
		<p>Faqe 8 of 23</p>

pritjen e vizitës vlerësuese miraton grupin e vlerësimit të propozuar nga menaxheri i dosjes, bazuar në analizën e burimeve dhe fushës së aplikimit/akreditimit. Grupi i vlerësimit formohet sipas politikës së DPA për grupet e vlerësimit (DA-PO-003).

DPA informon OVK për përbërjen e grupit të vlerësimit duke përfshirë gjithashtu edhe vëzhguesit, dhe i kërkon OVK konfirmimin e saj sipas formularit DA-FO-012.

OVK ka mundësinë të kundërshtojë një ose më shumë anëtarë të grupit vlerësues. Kur OVK paraqet një kundërshtim kundër emërimit të ndonjë anëtari ose vëzhguesve apo të gjithë grupit, DPA procedon sipas DA-PO-003.


6.5 Shqyrtimi i informacionit të dokumentuar

Kur OVK bie dakord me grupin e caktuar të vlerësimit, menaxheri i dosjes i siguron grupit të vlerësimit akses në dokumentacionin e OVK për ta shqyrtuar atë. Brenda 15 ditëve, secili anëtar i grupit duhet të japë informacione mbi moskonformitetet në dokumentacion sipas formave DA-FO-006 dhe DA-FO-007.

Nëse janë gjetur jokonformitete, DPA vendos të mos vazhdojë më tej me vlerësimin pa zgjidhur moskonformitetet. DPA raporton moskonformitetet me shkrim sipas formave DA-FO-006 dhe DA-FO-007. OVK ka të drejtë t'i ërgjigjet jokonformiteteve brenda 6 muajve. Nëse OVK nuk respekton afatin ose nuk zgjidh moskonformitetet, DPA përfundon procesin e vlerësimit dhe dërgon faturën tek OVK. Në rast të përfundimit të procesit të vlerësimit, OVK duhet të aplikojë përsëri.

Nëse nuk gjenden jokonformitete grupi vlerësues kryen analizën e riskut që lidhet me aktivitetet, vendndodhjet, personelin dhe fushën e akreditimit. Bazuar në vlerësimin e riskut, grupi i vlerësimit zhvillon një plan vlerësimi që mbulon aktivitetet, vendndodhjet dhe personelin që do të vlerësohet aty ku është e aplikueshme dhe teknikat e vlerësimit që duhet të përdoren duke përfshirë vlerësimin me dëshmi aty ku është e përshtatshme ose e aplikueshme. Grupi i vlerësimit propozon edhe datën e vlerësimit. Kohëzgjatja e vlerësimit bazohet në analizen e riskut.

DPA i njofton OVK datën e vlerësimit (DA-FO-005) dhe planin e vlerësimit (DA-FO-002). Data e vlerësimit të propozuar nuk mund të jetë më herët se 10 ditë pune nga njoftimi, me përjashtim të rasteve kur OVK pranon të zhvillohet më shpejt. OVK-së i kërkohet të miratojë datën dhe planin e vlerësimit. OVK ka mundësinë të refuzojë datën e zhvillimit të vizitës dhe planin e vizitës duke dhënë arsye objektive. Në këtë rast, DPA riplanifikon vizitën. Me miratimin e datës dhe planit, OVK është e detyruar të marrë të gjitha masat për të siguruar organizimin e vlerësimit sipas planit.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 9 of 23

Bazuar në planin e vlerësimit, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese llogarit tarifën e vlerësimit. OVK duhet të paguajë të paktën 80% të kostos së vlerësimit të paktën dy ditë para realizimit të vizitës vlerësuese. Nëse OVK nuk paguan paraprakisht, DPA nuk vazhdon me vizitën e vlerësimit.

6.6 Vlerësimi


Vlerësimi kryhet sipas procedurës së DPA për vizitën vlerësuese (DA-PT-002). Qëllimi i vizitës vlerësuese është vlerësimi i kompetencës së OVK, në bazë të standardeve dhe / ose dokumenteve të tjera normative dhe për një fushë të përcaktuar të aplikimit.

6.7 Marrja e vendimit të akreditimit

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, kryevlerësuesi i siguron Drejtorit të Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtorit të Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Emri i entiteti ligjor të OVK së vlerësuar
- data (t) dhe lloji i vlerësimit (fillestar / zgjerimi/ mbikëqyrja / riakreditim/ e jashtëzakonshme)
- Përbërja e grupit vlerësues
- Identifikimi i të gjitha vendndodhjeve të vlerësuar
- Fusha e akreditimit të vlerësuar
- Raporti i vlerësimit
- Jokonformitetet dhe informacion i mjaftueshëm për të demonstruar përgjigje të kënaqshme për të gjitha jokonformitetet
- Raportet mbi vlerësimet vertikale dhe vlerësimet me dëshmi
- Një deklaratë për përmbushjen e kërkesave të standardeve dhe / ose dokumenteve të tjera që lidhen me kompetencën e OVK.
- Rekomandim për akreditim tek vendimmarrësit.

Nëse entiteti ligjor është organ i lidhur, (Kategori 1 dhe kategori 2) Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, brenda tri ditëve, dorëzon dosjen e akreditimit, duke përfshirë të gjitha informacionet e përmendura më lart, tek grupi teknik përkatës. Grupi teknik përkatës shqyrton dosjen e akreditimit dhe formulon rekomandimin e tij për akreditim. Grupi teknik ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga kryevlerësuesi ose nga OVK para formulimit të rekomandimit të tij. Kryetari i grupit teknik, brenda 20 ditëve, i raporton Drejtorit të Përgjithshëm për procesin e akreditimit dhe rekomandimin

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 10 of 23

e grupit teknik sipas formularit DA-FO-016. Grupi Teknik funksionon sipas rregullores së tij të brendshme (skema 1). Raporti gjithashtu përfshin fushën/programin për të cilën duhet të jepet akreditimi.


Nëse entiteti ligjor nuk është organ i lidhur dhe sigurohet kompetenca dhe paanëshmëria e vendimarrësve, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese shqyrton dosjen e akreditimit duke përfshirë të gjithë informacionin e mesipërm dhe formulon rekomandimin e tij për akreditim. Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga kryevlerësuesi ose nga OVK, përpara se të formulojë rekomandimin e tij. Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, brenda 20 ditëve, i raporton Drejtorit të Përgjithshëm mbi proceset e akreditimit, dhe i jep rekomandimin sipas formularit DA-FO-016 (skema 2). Raporti gjithashtu përfshin fushën/programin për të cilën duhet të jepet akreditimi. Në rastet kur nuk sigurohet kompetenca ose paanëshmëria rekomandimi për akreditim formulohet nga grupi teknik përkatës i punës si në rastin e organeve të lidhura.

Drejtori i Përgjithshëm shqyrton informacionin e marrë dhe merr vendim në lidhje me akreditimin sipas formularit DA-FO-031. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese ose nga grupi teknik përkatës sipas formës DA-FO-090. Në rast të kërkimit të informacionit shtesë, Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese ose grupi teknik përkatës japin informacionin shtesë brenda 5 ditëve pune po sipas formës DA-FO-090. Afati maksimal për marrjen e vendimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është 30 ditë. Kur e shikon të nevojshme, për çështje teknike, Drejtori i Përgjithshëm mund të marrë mendimin edhe të grupit teknik përkatës të punës.

Në rastin e OVK të lidhura Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të marrë vendime të tjera nga sa është rekomanduar nga grupi teknik përkatës.

6.8 Informacioni i akreditimit

Nëse ky vendim mbi akreditimin, është pozitiv, ndiqet procedura DA-PM-014 për përgatitjen e certifikatës së akreditimit duke përfshirë informacionin lidhur me akreditimin.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 11 of 23

Drejtori i Përgjithshëm brenda 7 ditëve nga vendimi i akreditimit, i dorëzon, OVK-së të akredituar dokumentat e mëposhtëm:

- Certifikata of Akreditimit shoqëruar me fushën/programin e akreditimit,
- Simbolin e akreditimit
- Kopje të raportit të vlerësimit (nëse është i ndryshëm nga ai i treguar në kapitullin 6.6)

OVK ka detyrimin që të njihet me dokumentat e mëposhtëm të cilët i gjen në faqen e DPA:

- Politika për përdorimin e simbolit të akreditimit DA-PO-005.
- Procedurën e te drejtat dhe detyrimeve të OVK, DA- PM – 011

Në fund të procesit, DPA dërgon faturën përfundimtare tek OVK në lidhje me çfarë ai i detyrohet DPA (p.sh. shpenzimet e certifikatës ose veprime të tjera shpesh të ndërrmarra gjatë procesit të akreditimit).

Nëse vendimi është negativ, brenda 7 ditëve, Drejtori i Përgjithshëm i jep me shkrim OVK së vlerësuar informacionin për refuzimin e akreditimit. OVK ka të drejtë të apelojë vendimin, brenda 4 javësh nga data e vendimit. Kur DPA i paraqitet një apelim, DPA fillon të ndjekë procedurën e apeliave, DA-PM-005.

E gjithë dosja e akreditimit, pavarësisht vendimit, i dorëzohet Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibruar dhe mjekësorë/ Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektuese, i cili kontrollon inventarin e të gjithë dokumentacionit sipas DA-FO-059 përpara se t'ia përcjellë atë për arkivim sipas procedurës së kontrollit të regjistrimeve, DA-PM-009.

Drejtorja e Zhvillimit e regjistron OVK e akredituar në regjistrin përkatës dhe e publikon atë në faqen zyrtare të DPA-së.

7. Cikli i akreditimit

Cikli i parë i akreditimit fillon në datën e vendimit të akreditimit fillestar. Kohëzgjatja e cdo cikli akreditimi (dhe si rrjedhim edhe vlefshmëria e certifikatës së akreditimit) është 4 vjet (48 muaj) nga data e akreditimit fillestar me kusht që rezultatet e mbikëqyrjeve dhe rivlerësimi të jenë të suksesshme.

Në rastin e rinovimit të akreditimit, periudha e vlefshmërisë së ciklit të ri dhe certifikatës përcaktohet gjithmonë duke i shtuar periudhën 4 vjeçare (48 mujore) dates së vlefshmërisë së akreditimit të mëparshëm. Data efektive e vendimeve të rinovimit të akreditimit, të marra brenda ciklit të akreditimit, është dita e ardhshme pas përfundimit të



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit

Kodi: DA – PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Faqe 12 of 23

ciklit aktual të akreditimit (datës së vlefshmërisë së certificates). OVK e akredituar mban gjithashtu të njëjtin numër identifikues të akreditimit për ciklin pasues të akreditimit


Nëse vendimi i rinovimit të akreditimit është marrë brenda 3 muajve pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës (akreditimi nuk është i vlefshëm brenda kësaj periudhe), data efektive e certifikatës bëhet data në të cilën është marrë vendimi. Në mënyrë të ngjashme, periudha e vlefshmërisë së ciklit të ri dhe certifikata përcaktohen duke i shtuar periudhën 4 vjeçare (48 muaj) datës së vlefshmërisë së akreditimit të mëparshëm. OVK nuk mban të njëjtin numër identifikues të akreditimit për ciklin pasues të akreditimit. Nëse një vendim i rinovimit të akreditimit nuk merret brenda 3 muajve pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës për shkak të arsyeve që vijnë nga OVK, data e efektive e certifikatës është data në të cilën është marrë vendimi dhe cikli 4 vjeçar i akreditimit fillon në po atë datë, por quhet akreditim fillestar. OVK e akredituar nuk mban të njëjtin numër identifikues të akreditimit për ciklin pasues të akreditimit. Periudha nga mbarimi i vlefshmërisë së akreditimit të mëparshëm, deri në fillimin e vlefshmërisë së akreditimit nuk mbulohet nga cikli i akreditimit.

Pas marrjes së akreditimit për një cikël të ri të akreditimit, grupi i vlerësimit harton programin e vlerësimeve për të gjithë ciklin 4 vjeçar të akreditimit sipas formave përkatëse (DA-FO-069, DA-FO-084, DA-FO-085, DA-FO-086, DA-FO-087, DA-FO-088) për të siguruar që kërkesat për akreditim plotësohen dhe e gjithë veprimtaria e vlerësimit të konformitetit e akredituar mbulohet gjatë periudhës katër vjeçare. DPA duhet të dërgojë tek OVK programin e vlerësimeve jo më vonë se dy muaj nga fillimi i ciklit të ri të akreditimit.

Programi i vlerësimeve bazohet në analizën e rezikut. Programi i vlerësimeve është subjekt i ndryshimeve para dhe pas çdo vlerësimi/mbikëqyrje si dhe në rastin e ndryshimeve nga ana e OVK (psh: stafi, dhe/ose vendndodhja, metodat/standardet e testimit, pajisjet dhe aparatet, ekzistenca e jokonformiteteve, rezultatet jo të kënaqshme në krahasimet ndërlaboratorike, ankesat e klientëve, zgjerimi / reduktimi i akreditimit). Në rast të ndryshimeve nga ana e OVK, bazuar në vlerësimin e riskut, DPA i dërgon OVK, programin e vlerësimeve të ndryshuar.

Vizita për rinovimin e akreditimit (rivlerësuese) është pjesë e ciklit të akreditimit dhe kryhet brenda periudhës në të cilin cikli i akreditimit është i vlefshëm. Normalisht, një cikël akreditimi përbëhet nga vizitat mbikëqyrëse dhe ajo rivlerësuese. Gjatë ciklit të parë të akreditimit, vizita e parë mbikëqyrëse në OVK do të kryhet 6 muaj nga data e fillimit të ciklit. Mbikëqyrja e dytë kryhet 12 muaj pas mbikëqyrjes së parë. Mbikëqyrja e tretë do të kryhet 12 muaj pas mbikëqyrjes së dytë. Në mbikëqyrjen e dytë dhe të tretë mund të lejohet një devijim maksimal prej 2 muajsh. Vizita për rinovimin e akreditimit (rivlerësimi) ose vizita mbikëqyrëse (nëse OVK nuk ka aplikuar për rinovim të akreditimit) kryhet në vitin e katërt të akreditimit, por të paktën 8 muaj përpara përfundimit të ciklit të akreditimit

Gjatë cikleve të tjera të akreditimit, vizita e parë mbikëqyrëse në OVK e akredituar do të kryhet 12 muaj nga data e fillimit të ciklit. Mbikëqyrja e dytë dhe e tretë do të kryhet 12

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 13 of 23

muaj pas mbikëqyrjes pararendëse. Në vlerësimet rutinë mund të lejohet një devijim maksimal prej 2 muajsh. Vizita për rinovimin e akreditimit (rivleresimi) ose vizita mbikëqyrëse (nëse OVK nuk ka aplikuar për rinovim të akreditimit) kryhet në vitin e katërt të akreditimit, por të paktën 6 muaj përpara përfundimit të ciklit të akreditimit.

Vizitat mbikëqyrëse ose rivlerësuese mund të kryhen në vend (në vendndodhjen e OVK) ose me vlerësim në distancë, ose një kombinim i të dyjave (kombinim i vizitës në vend me vizitën në distancë) bazuar në analizën e riskut. Vendimmarja në lidhje me mënyrën e organizimit të vizitës dhe teknikat që do të përdoren i takon DPA. Koha ndërmjet dy vizitave të njëpasnjëshme në vend nuk duhet të kalojë 2 vjet. Vleresimet me dëshmi të përzgjedhura bazuar në analizën e riskut duhet të kryhen të paktën cdo dy vjet.

DPA u kërkon OVK –ve të akredituara që të dorëzojnë të paktën 30 ditë para kryerjes së çdo vizite mbikëqyrëse të gjithë informacionin e kërkuar sipas formës DA-FO-083. Për vizitën mbikëqyrëse, DPA ndjek këtë procedurë nga kapitulli 6.3. Në fund të cdo vizite mbikëqyrëse do të jepet një vendim në lidhje me mirëmbajtjen e statusit të akreditimit. Vendimi për mirëmbajtjen e akreditimit mund të shoqërohet me zgjerim ose reduktim të fushës së akreditimit.

Numri i vlerësimeve të mbikëqyrjes parashikuar për një cikël akreditimi, mund të rritet për arsyet e përmendura më poshtë:

* Kërkesa për zgjerimin e fushës, ankesat, ndryshimet në rregulloret dhe standardet e fushës së veprimtarisë së OVK, ndryshimet në strukturën e OVK, pezullim i akreditimit etj.


* Kërkesat e dhëna në programin përkatës të akreditimit dhe programin e ciklit të akreditimit,

* Kur vlerësimet me dëshmi nuk mund të kryhen në vazhdimësi me vlerësimet në zyrë.

Kur është e mundur, vëmendje i kushtohet kryerjes së vlerësimeve me dëshmi, së bashku me mbikëqyrjen e planifikuar dhe rivlerësimet. Megjithatë, në rastet kur vlerësimi me dëshmi nuk mund të kryhet së bashku me vlerësimin e mbikëqyrjes dhe rinovimit brenda periudhës 3 mujore, mund të kryhen vlerësime me dëshmi të pavarura para ose pas vlerësimit përkatës në përputhje me programin e vlerësimeve.

8. Vizitat vlerësuese të jashtëzakonshme

DPA organizon vlerësim të jashtëzakonshëm si rezultat i ankesave, ndryshimeve ose çështjeve të tjera (raportet e vlerësuesve teknikë) që mund të ndikojnë në aftësinë e OVK për të përmbushur kërkesat për akreditim. Kohëzgjatja e vlerësimit dhe teknikat e vlerësimit që do të përdoren në vizitën e jashtëzakonshme, vendosen duke u bazuar në analizën e rrezikut. DPA kryen vlerësimet e jashtëzakonshme në përputhje me kapitujt 6.3 deri 7 të kësaj procedure dhe procedurën DA-PT-002.

 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	<p>Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit</p>	<p>Kodi: DA – PT - 001</p> <hr/> <p>Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024</p> <hr/> <p>Faqe 14 of 23</p>
---	--	---

9. Rinovimi i akreditimit (Rivlerësimi)

OVK e akredituar duhet të aplikojë për rinovimin e akreditimit përpara përfundimit të ciklit të akreditimit. Nëse OVK aplikon, DPA kryen vizitën rivlerësuese në vitin e katërt të ciklit aktual të akreditimit. Në ciklin e parë të akreditimit, DPA planifikon dhe kryen rivlerësimin të paktën 8 muaj para përfundimit të ciklit të akreditimit. Për ciklet e tjera të akreditimit, rivlerësimi duhet të kryhet të paktën 6 muaj përpara përfundimit të ciklit të akreditimit.


Rinovimi i akreditimit planifikohet, kryhet dhe raportohet si vlerësimi për akreditim fillestar, bazuar në këtë procedurë, duke filluar nga kapitulli 6 dhe në procedurën DA-PT-002. Me marrjen e kërkesës për riakreditim, DPA dhe OVK do të firmosin kontratën DA-FO-038.

Nëse OVK aplikon për rinovim të akreditimit pa ndryshim në fushën e akreditimit, rivlerësimi ndërmerret për të rivlerësuar kompetencën dhe konformitetin e OVK kundrejt kritereve të aplikueshme të akreditimit dhe kërkesave të tjera përkatëse duke përfshirë edhe vlerësimin e aktiviteteve të përzgjedhura sipas programit të vlerësimeve (duke siguruar që e gjithë fusha do të mbulohet në mënyrë të përshtatshme të paktën njëherë, gjatë ciklit katër vjeçar të akreditimit).

Nëse OVK aplikon për rinovim të akreditimit me zgjerim/ndryshim të fushës së akreditimit, rivlerësimi përfshin rivlerësimin e kompetencës dhe konformitetit të OVK kundrejt standardeve të aplikueshme të akreditimit dhe kërkesat e tjera përkatëse duke përfshirë përveç vlerësimit të aktiviteteve të përzgjedhura sipas programit të vlerësimit (duke siguruar që e gjithë fusha do të mbulohet në mënyrë të përshtatshme të paktën njëherë, gjatë ciklit katër vjeçar të akreditimit), edhe vlerësimin e aktiviteteve të përzgjedhura që përfaqësojnë zgjerimin/ndryshimin e fushës së akreditimit. Përzgjedhja e aktiviteteve që do të vlerësohen që përfaqësojnë zgjerimin/ndryshimin e fushës së akreditimit bazohet në analizën e riskut.

Nëse OVK aplikon për rinovimin e akreditimit me vonë, ose pas kryerjes së vizitës mbikëqyrëse në vitin e katërt të akreditimit ose nëse rivlerësimi nuk mund të kryhet brenda ciklit të akreditimit për shkaqe që varen nga OVK, statusi i akreditimit humbet dhe dosja arshivohet kur cikli i akreditimit mbaron. OVK duhet të aplikojë për akreditim fillestar.

Nëse OVK nuk aplikon për rinovim të akreditimit deri në dy muaj përpara mbarimit të akreditimit, menaxheri i dosjes informon Drejtorin e Drejtorisë së laboratorëve testues,

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Faqe 15 of 23

kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorin e Drejtorisë së organeve certifikues dhe inspektues dhe më pas Drejtorin e Përgjithshëm për arshivimin e dosjes. Dosja duhet të arshivohet pas mbarimit të statusit të akreditimit. Kur statusi i akreditimit ka mbaruar, emri i OVK fshihet nga database në faqen e internetit të DPA.

10. Informimi / komunikimi i brendshëm

Cdo vendim për akreditim që merret nga Drejtori i Përgjithshëm, specialisti i sektorit të financës dhe shërbimeve në DPA informon me email brenda pesë dite nga marrja e vendimit, Drejtorin e Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtorin e Drejtorisë së organeve certifikues dhe inspektues, Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit dhe Përgjegjës të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve. Drejtorja e Zhvillimit përditëson të dhënat e OVK në faqen e internetit të DPA.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit


Kodi: DA - PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Faqe 16 of 23

11

DIAGRAM





Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

**Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe
rinovimit**

Kodi: DA – PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Page 17 of 23




Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al


Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit

Kodi: DA - PT - 001


Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Faqe 18 of 23





 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		faqe 19 of 23

Skema 1- Marrja e vendimit për OVK e lidhura



Skema 2: Marrja e vendimit për OVK –jo të lidhura



 <p>Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit	Kodi: DA – PT - 001
		Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
		Page 20 of 23

12. RREGJISTRIME QË DALIN NGA KJO PROCEDURË

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
Check lista	Grupi vlerësues	Kur shqyrtohet dokumentacioni	Arshiva
Forma e vlerësimit të dokumentacionit të sistemit të menaxhimit DA – FO- 006	Kryevlerësuesi	Kur shqyrtohet dokumentacioni	Arshiva
Forma e vlerësimit të procedurave teknike DA –FO – 007	Vlerësuesi teknik	Kur shqyrtohet dokumentacioni	Arshiva
Forma e paraqitjes së veprimeve korrigjuese DA-FO-011	Grupi vlerësues	Pas vlerësimit	Arshiva
Forma e njoftimit të datës së vlerësimit dhe miratimi i saj DA-FO-005	Menaxheri i dosjes	Pas shqyrtimit të dokumentacionit	Arshiva
Forma grupit të vlerësimit DA-FO-70	Kryevlerësuesi	Pas takimit	Arshiva
Forma për planin vjetor për vlerësimet me dëshmi DA-FO-069	Grupi vlerësues	Pas dhënies së akreditimit	Arshiva
Plani i vizitës vlerësuese DA-FO-002	Menaxheri i dosjes	Para vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e njoftimit të emrave të grupit dhe aprovimit të tij DA-FO-012	Menaxheri i dosjes	Para vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e raportimit të vlerësimit të laboratorëve DA-FO-001	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e raportimit të vlerësimit për organizmat certifikues të personelit DA-FO-013	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e raportimit të vlerësimit për organizmat certifikues të produkteve DA-FO-049	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e raportimit të vlerësimit për organizmat inspektues DA-FO-048	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al


Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit

Kodi: DA - PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Page 21 of 23

Forma e raportimit të vlerësimit për organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit DA-FO-004	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e raportimit tek Drejtori i Përgjithshëm DA-FO-016.	Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikues dhe inspektues	Pas vlerësimit	Arshiva
Forma e paraqitjes së moskonformiteteve DA-FO-003	Grupi vlerësues	Pas vizitës vlerësuese	Arshiva
Forma e planit të zgjidhjes së moskonformiteteve DA-FO-031	OVK e vlerësuar	Pas vizites vlerësuese	Arshiva
Hartimi i çertifikatës	Specialisti i sektorit të Finances dhe Shërbimeve	Kur lëshohet apo ndryshohet një dokument	Arshiva
Raporti i paravlerësimit DA-FO-043	Grupi vlerësues	Pas vizites paravlerësuese	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit për laboratorë testues, DA-FO-069	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit për laboratorë kalibrues DA-FO-084	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit për laboratorë mjekësorë, DA-FO-085	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit për organe certifikuese të sistemeve të menaxhimit DA-FO-086	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit për organe certifikuese të personave DA-FO-087	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva
Forma e programit të vlerësimit	Grupi vlerësues	Pas marrjes së vendimit	Arshiva

 Tel: + 355 4 2 269097 Fax : + 355 4 2 269325 E-Mail: info@dpa.gov.al	Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit		Kodi: DA - PT - 001
			Rishikim nr 12 Dt: 28.06.2024
			Faqe 22 of 23

për organe inspektuese, DA-FO-088			
Forma për informacionin shtesë në lidhje me procedurat e akreditimit, DA-FO-090	Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikues dhe inspektues ose grupi teknik i punës	Përpara marrjes së vendimit	Arshiva

13. HISTORIKU

Data e ripunimit	Numri i rishikimit	Hartoi	Përshkrimi i ndryshimeve
30. 10. 2006	0	Briseida Xhafa	Versioni fillestar.
05.11.2008	1	Briseida Xhafa	Këto ndryshime janë bërë në bazë të ndryshimeve në ligjin e akreditimit Nr. 9824, datë 06.03.2003, “Për akreditimin e Organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, sipas plotësimit të komplet kërkesave të standardit S SH ISO 17011. Ndryshime janë pasqyruar në pikat e mëposhtme të procedurës: 6.2.1, 6.2.2, 6.2.3, 6.2.5 6.2.6, 6.3.2, 6.5 6.6.1, 6.6.3, 6.6.4, 7.1, 7.2, 7.3 dhe 8.



Tel: + 355 4 2 269097
Fax : + 355 4 2 269325
E-Mail: info@dpa.gov.al

Proçedura e akreditimit, mbikëqyrjes dhe rinovimit

Kodi: DA - PT - 001

Rishikim nr 12
Dt: 28.06.2024

Faqe 23 of 23

30.10.2009	2	Ermira Fyshku	Janë bërë disa plotësime të kësaj procedure në pikat : 2 ; 4 ; 6.2.5 për të pasqyruar politikën e vlerësimit DA-PO-002 Në pikën 2 është shtuar shënimi për fushën e zbatimit. Në pikën 2 është shtuar shënimi 1* për formën e aplikimit. Në pikën 6.2 shtuar shënimi 2* për planin e vlerësimit. Në pikën 7. Mbikëqyrja, është shtuar shënimi në lidhje me që DPA në rast se në ovk ndryshon drejtori ose menaxheri i cilë
		Besnik Pani	
21.07.2011	3	Besnik Pani	Janë bërë disa plotësime të kësaj procedure në pikat: 4 ; 6.2.2 ; 6.2.5 ; 6.2.6 ; 6.6.3 ; 7.2 ; 8, 9 si dhe në diagramë. Jane zvogeluar afatet e procedurës se akreditimit si dhe është vendosur menyra e informimit te brendshem ne lidhje me vendimarrjen e Drejtorit te Pergjithshem.
04.06.2013	4	Ardita Fuga	Paragrafi 6.5 dhe 6.6 në lidhje me ndryshimin e procesit të vendimarrjes në rastet e OVK të lidhura.
22.12.2014	5	Briseida Xhafa	Ndryshime ne paragrafin 6.2 per organet e lidhura, ndryshime ne header dhe reflektimi i ligjit te ri.
27.01.2017	6	Briseida Xhafa	Zvogelimi i kohëzgjatjes së procedurës
0.06.2017	7	Briseida Xhafa	Ndryshime në paragrafin 6.2.6 rreth takimit të grupit të vlerësimit dhe plani vjetor për vlerësimet me dëshmi
20.05.2019	8	Briseida Xhafa	Ndryshimet bazohen në standardin e ri ISO/IEC 17011:2017
25.05.2021	9	Ardita Mele	Ndryshime në paragrafët 6; 7 dhe 9
08.06.2022	10	Ardita Mele	Ndryshimi në paragrafët 6.5 ; 7 dhe 10
04.01.2024	11	Ardita Mele	Ndryshime në paragrafët 4; 6.2; 6.3; 6.7; 6.8 dhe 9
28.06.2024	12	Ardita Mele	Ndryshim në paragrafet 6.3 dhe 6.5 në lidhje me klasifikimin e moskonformiteteve